



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:042965

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05385689

C.nr.731/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtare Diora Bajrami, me bashkëpunëtoren profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditësve E.N. me numër personal E.T. me numër personal E.L. me numër personal E.K. me numër personal dhe E.S. me numër personal që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av.F.S. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 13,860.60 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 28.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I.** APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve E.N., E.T., E.L., E.K. dhe E.S. që të gjithë nga Prizreni, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.
- II.** DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, ti paguaj shumat si në vijim:
 1. Paditëses E.N. për periudhën kohore prej datës 01.03.2019 deri më datë 18.04.2021 apo për 25 muaj e 18 ditë (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, si dhe për 18 ditë, shumën prej 33.21 € në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,416.96 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 03.03.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
 2. Paditësit E.T. për periudhën kohore prej datës 01.03.2019 deri më datë 18.04.2021 apo për 25 muaj e 18 ditë (për çdo muaj shumën prej 38.95 euro, në shkallë prej 19 % të pagës bazë - 421 euro, si dhe për 18 ditë, shumën prej 23.36 € në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 996.11 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 03.03.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
 3. Paditëses E.L. për periudhën kohore prej datës 01.09.2019 deri më datë 18.04.2021 apo për 19 muaj e 18 ditë (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës

- bazë - 421 euro, si dhe për 18 ditë, shumën prej 33.21 € në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,084.86 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 03.03.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.
4. Paditësit E.K. për periudhën kohore prej datës 01.03.2019 deri më datë 18.04.2021 apo për 25 muaj e 18 ditë (për çdo muaj shumën prej 91.45 euro, në shkallë prej 35 % të pagës bazë - 495.30 euro, si dhe për 18 ditë, shumën prej 54.86 € në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 2,341.11 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 03.03.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.
5. Paditëses E.S. për periudhën kohore prej datës 01.03.2019 deri më datë 18.04.2021 apo për 25 muaj e 18 ditë (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, si dhe për 18 ditë, shumën prej 33.21 € në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,416.96 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 03.03.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve E.N., E.T., E.L., E.K. dhe E.S. përtej shumës së gjykuar si në pikën II. të këtij dispozitivi të aktgjykimit, ashtu që paditëses E.N. dhe paditësit E.S. për secilën veç e veç iu refuzua shuma prej 1,239.84, paditësit E.T. iu refuzua shuma prej 873.49 euro, paditësit E.K. iu refuzua shuma prej 2,343.69 euro si dhe paditëses E.L. iu refuzua shuma prej 907.74 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

IV. DETYROHET e paditura, që paditësve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 332.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit E.N., E.T., E.L., E.K. dhe E.S. që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.F.S. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me dt. 03.03.2022, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 13,860.60 euro.

I autorizuari i paditësve në padi ka theksuar, se paditësit janë të punësuar si mësimdhënës pranë SHFMU "Motrat Qiriazit" në Prizren, ku vazhdojnë të punojnë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se duke u bazuar në nenin 7 të Kontratës kolektive të arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017, paditësit kanë fituar të drejtën e tyre në kompensim në bazë të kualifikimit-licencimit. Bazuar në këtë kontratë, me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi, dhe atë, mësimdhënësve me shkollë normale 10% e pagës bazë, Mësimdhënës me shkollë të lartë

pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë, Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë, Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçare, magjistraturë dhe doktoratë 35% e pagës bazë. Bazuar në të lartëcekurat, ka kërkuar nga gjykata që paditëses E.N. të ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2656.80 euro, paditësit E.T. t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1869.60 euro, paditëses E.L. t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1992.60 euro, paditësit E.K. t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 4684.80 euro si dhe paditëses E.S. t'ia paguaj shumën prej 2656.80 euro. Andaj, paditësit kanë kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore, i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAJ-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAJ-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 353 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, duke deklaruar se paditësit kanë humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që kërkesa për kompensim të kualifikimit për vitin 2017 dhe deri me ditën e parashtrimit të padisë është parashkruar, sepse kanë kaluar 3 vite. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit E.N., E.T., E.L., E.K. dhe E.S. janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SHFMU “Motrat Qiriazi” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve u takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësve për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Nga kontrata e punës me numër protokolli 443 e nënshkruar me datë 28.10.2015, ndërmjet paditësve dhe të paditurës, rezulton se paditësja E.N. është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse, kualifikimi i paditësve është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 779, e datës 23.06.2016 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prizren, në emër të paditësve, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësve është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokoll 419 e nënshkruar me datë 28.10.2015, ndërmjet paditësit dhe të paditurës, rezulton se paditësi E.T. është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës i lëndës edukatë fizike, kualifikimi i paditësit është kualifikim i lartë shkollor, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e kulturës fizike, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 563, e datës 29.10.2010 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit-në Prishtinë, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin arsimtar i kulturës fizike. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësin është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit SHLP, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 41.04 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokoll 747 e datës 01.09.2019, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se paditësja E.L. është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse nga data 01.09.2019, ndërsa nga vërtetimi nr. 155 i dt. 22.06.2021, lëshuar nga drejtori S.Sh. u vërtetua se paditësja deri me dt. 22.06.2021 ka 3 vite përvojë pune, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 588, e datës 14.03.2017 e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit, Fakulteti i Edukimit, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësin është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokoll 01-112-155848/01 e datës 19.10.2018, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, rezulton se paditësi E.K. është i punësuar tek e paditura si zëvendës drejtor i SHFMU “Motrat Qiriazi” nga data 19.10.2018 deri me dt. 18.10.2022, ndërsa nga kontrata e punës me nr. prot. 351-24 e dt. 15.05.2014 u vërtetua se paditësi nga dt. 12.05.2014 deri me dt. 12.05.2018 është i punësuar tek e paditura si zëvendës drejtor i SHFMU “Motrat Qiriazi”, kualifikimi i paditësit është kualifikim master, respektivisht i njëjti ka të përfunduar masterin në fakultetin e biologjisë, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 01000187, e datës 11.07.2006, e lëshuar nga Universiteti i Gazi në Turqi, në emër të paditësit. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësit është me koeficient 7.2, (e barasvlefshme me shumën 495.30 euro) dhe se paditësit në emër të kualifikimit Dr.-Mr, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 81.90 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokoll 546 e nënshkruar me datë 28.10.2015, ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se paditësja E.S. është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e filologjisë-dega gjuhë dhe letërsi turke, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 344, e datës 20.02.2004, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin profesor. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësin është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë

besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratat e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar një pjesë të shumës në emër të kualifikimit. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit E.N., E.L., E.K. dhe E.S. përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, paditësi E.T. përfiton ngritje prej 19% të pagës bazë ndërsa paditësi E.K. përfiton ngritje prej 35% të pagës bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit. Andaj, gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën:

Që paditëses E.N. për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo 27% të pagë bazë prej 421 euro, diferencën e mbetur për 25 muaj e 18 ditë, nga data 01.03.2019 e deri më datë 18.04.2021, në shumë të përgjithshme prej 1,416.96 euro ($25 * 55.35 = 1,383.75$ si dhe periudha 18 ditë të muajit Prill 2021 është 33.21 sipas $(55.35/30 = 1.845 * 18 \text{ ditë} = 33.21)$ $1,383.75 + 33.21 = 1,416.96$ euro.

Paditësit E.T. për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 38.95 euro apo 19% të pagë bazë prej 421 euro, diferencën e mbetur për 25 muaj e 18 ditë, nga data 01.03.2019 e deri më datë 18.04.2021, në shumë të përgjithshme prej 997.12 euro ($25 * 38.95 = 973.75$ si dhe periudha 18 ditë të muajit Prill 2021 është 23.37 sipas $(38.95/30 = 1.298 * 18 \text{ ditë} = 23.37)$ $973.75 + 23.37 = 997.12$ euro.

Paditëses E.L. për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo 27% të pagë bazë prej 421 euro, diferencën e mbetur për 19 muaj e 18 ditë, nga data 01.09.2019 e deri më datë 18.04.2021, në shumë të përgjithshme prej 1,084.86 euro ($19 * 55.35 = 1,051.65$ si dhe periudha 18 ditë të muajit Prill 2021 është 33.21 sipas $(55.35/30 = 1.845 * 18 \text{ ditë} = 33.21)$ $1,051.65 + 33.21 = 1,084.86$ euro.

Paditësit E.K. për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 91.45 euro apo 35% të pagë bazë prej 495.30 euro, diferencën e mbetur për 25 muaj e 18 ditë, nga data 01.03.2019 e deri më datë 18.04.2021, në shumë të përgjithshme prej 2,341.11 euro ($25 \cdot 91.45 = 2,286.25$ si dhe periudha 18 ditë të muajit Prill 2021 është 54.86 sipas $(91.45/30 = 3.048 \cdot 18 \text{ ditë} = 54.86)$ $2,286.25 + 54.86 = 2,341.11$ euro.

Paditëses E.S. për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo 27% të pagë bazë prej 421 euro, diferencën e mbetur për 25 muaj e 18 ditë, nga data 01.03.2019 e deri më datë 18.04.2021, në shumë të përgjithshme prej 1,416.96 euro ($25 \cdot 55.35 = 1,383.75$ si dhe periudha 18 ditë të muajit Prill 2021 është 33.21 sipas $(55.35/30 = 1.845 \cdot 18 \text{ ditë} = 33.21)$ $1,383.75 + 33.21 = 1,416.96$ euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 03.03.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 03.03.2022, ndërsa kërkesa e tyre ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 28.02.2019, dhe atë secilit paditës i është refuzuar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri me dt. 28.02.2019 ashtu që për paditësen E.N. dhe paditësit E.S. për secilën veç e veç u refuzua shuma prej 1,239.84, paditësit E.T. iu refuzua shuma prej 873.49 euro ndërsa paditësit E.K. iu refuzua shuma prej 2343.69 euro.

Ndërsa sa i përket paditëses E.L. nga provat e paraqitura nga vet pala paditëse, konkretisht nga kontrata e punës, gjykata ka vërtetuar se paditësja E.L. ka filluar marrëdhënien e punës pranë të paditurës me datë 01.09.2019, po ashtu nga vërtetimi nr. 155 i dt. 22.06.2021, lëshuar nga drejtori S.Sh. doli se paditësja deri me dt. 22.06.2021 ka pasur 3 vite përvojë pune, andaj edhe gjykata e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses dhe atë duke filluar nga data 01.09.2019 e deri me dt. 18.04.2021, ndërsa ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë përpara kësaj date për faktin se palët ndërgjyqjës nuk kanë pasur raport kontraktual pra para kësaj date e paditura nuk ka pasur asnjë obligim ndaj paditëses.

Sa i përket paditësit E.K. gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesën e tij, sepse nga lista e pagave të dorëzuar pranë kësaj gjykate nga vet paditësi, del se paga bazë e të njëjtit është në koeficientin 7.2, e bazuar në njoftimin e MASHT-it me numër protokolli 4540 të datës 11.12.2023, del se lartësia e pagës së paditësit në koeficient 7.2 është në lartësi 495.30 euro, e jo siç ka pretenduar paditësi se është në lartësi prej 512.95 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të

cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 332.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 312 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.731/2022 të datës 28.02.2024

Gjyqtare,
Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.